

RAPORTI I AUDITUESES SE PAVARUR

PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2017

Shoqëria “GJOKA KONSTRUKSION-ENERGJI”SHPK

**NIPT L01815004G
TIRANE**

Përmbajtja

- ◆ RAPORTI I AUDITUESES SE PAVARUR
- ◆ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
- ◆ PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE
- ◆ PASQYRA E CASH FLOW
- ◆ PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALEVE

RAPORT I AUDITUESES TË PAVARUR

Për Ortakët e Shoqërisë "GJOKA KONSTRUKSION-ENERGJI" shpk

Opinion

Une kam audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "GJOKA KONSTRUKSION-ENERGJI" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK e permiresuara).

Baza për Opinionin

Une e kreu auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Unë jam e pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Unë besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat e mia janë që të arrij një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshoj një raport auditimi që përfshin opinionin tim. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të IEKA-s në: www.ieka.al
Ky përshkrim përbën pjesë të raportit të auditimit.

AUDITUESE E PAVARUR

Shpresa BREÇANI
Nr lic 143

Tirane , me 27.03.2018



Informacion i Pergjithshem

Shoqeria "GJOKA KONSTRUKSION- ENERGJI" shpk eshte rregjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar regjistruar prane QKR-se, date 15/06/2010, ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare". Kapitali i shoqerise eshte 1.000.000 leke.

Struktura e kapitalit te shoqerise eshte e ndare si me poshte:

- Gjoka Konstruksion sha, pjesmarrja 60%,
- Eldris-05 shpk , pjesmarrja 30%,
- Shpetim Selimollari, pjesmarrja 10%.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Zbatim i kontrates me Autoritetin Kontraktues, Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes te dates 04.05.2010 (Nr 2217 Rep, Nr 1070 Kol). Shoqeria ka si objekt kryerjen e veprimtarise se ndertimit, operimit dhe transferimit te hidrocentraleve "Lenis", "Shales", "Strelce" tek Autoriteti Kontraktues ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike.

Organet Drejtuese te shoqerise perfaqesohen nga administratori Z. Elvis Gjoka.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Abdi Toptani", Torre Drini, Kati i dyte, Zyra Nr.25, Tirane.

Shoqeria eshte e regjistruar si person juridik ne Drejtorine Rajonale Tatimore Tirane me NIPT L01815004G.

Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare,

Pasqyrat Financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 jane pergatitur ne perputhje me rregullat dhe interpretimet e ligjit Nr. 9228, date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) te aprovuara nga Keshilli Kombetar I Kontabilitetit (KKK).

Pasqyrat financiare janë pergatitur mbi bazen e kostos historike minus amortizimin e akumuluar, me perjashtim te rasteve nese percaktohet ndryshe.

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SKK-ve, kerkon qe manaxhimi te beje vleresime, gjykime e supozime qe ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe vleren e raportuar te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime. Vleresimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen kur ndodh rishikimi dhe ne cdo periudhe te ardhme qe preket.

Monedha Funktionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqeria. Informacioni ne pasqyrat financiare eshte paraqitur ne Leke.

Vlerësime dhe gjykime,

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjve gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Permbledhje e politikave të rëndësishme kontabel,

Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë të shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhena, depozita bankare dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Njohja fillestare dhe cregjistrimi

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjale. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Aktivitetet financiare cregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare cregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Njohja e metejshme

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me koston e amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvlerësimet.

Vleresimi i likujditeteve,

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogarite e arketueshme afatshkurtra nuk skontohen.

Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Kerkesat për arketim vleresohen me vlerën nominale minus humbjen nga zhvlerësimi. Ato nuk janë vlerësuar me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të llogaritur vlerën e interesit të papërfutur në pasqyrat financiare përderisa nuk ka efekte materiale të këtyre interesave në datën e mbylljes së bilancit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe detyrimet financiare të mesipërme zhvleresohen sikurse dhe nëpërmjet procesit të amortizimit.

Zhvleresime të aktiveve financiare.

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi.

Veshtiresitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arketueshme është e zhvlerësuar.

Aktivitet e rëndësishme financiare testohen në mënyrë individuale për zhvlerësim. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi bazë grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar (kreditor).

Humbja nga zhvlerësimi lidhet me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës kontabel të aktivitet dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit të aktivitet.

Vlera e nje aktivi zvogelohet nepermjet llogarise per zhvleresime dhe vlera e humbjes nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te rriten mbi vleren kontabel te aktualizuar, bazuar ne normen origjinale efektive te aktivitetit. Llogarite e arketueshme se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit qe i shoqeron c'registroheshen atehere kur nuk ka shpresa per rikuperim real ne te ardhmen.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Nëse ne nje vit pasues, shuma e humbjeve te vleresuara nga zhvleresimi rritet apo ulet per shkak te nje ngjarje pas njohjes fillestare te aktivitetit, humbja nga zhvleresimi i njohur me pare rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarine e fondit rezerve te zhvleresimeve. Nëse nje aktiv i cregjistruar me pare, rikuperohet, ky rikuperim njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvleresimi i Aktiveve jo-financiare,

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Njohja dhe matja

Aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitetit.

Kostoja e aktiveve të kualifikuara përfshin kostot e interesit të kryera gjatë periudhave të ndertimit, nëse ka, bazuar në normen mesatare të maturimit të huadhenies.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndertimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndertimi i tij.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ne rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshifet dhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese.

Kostot e inventarit janë përlogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshihen shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dergimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

Gjendjet e Inventarit janë të rregjistruara dhe të vlerësuara në bilanc me vlerën e drejtë.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlogaritur të perfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe për punimet në proces që nuk janë në funksionim.

Amortizimi për Aktiveve Afatgjata Jomateriale njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve të patrupezuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Cregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më fitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbartur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Njohja dhe Matja

Liçensat dhe të drejtat e përdorimit paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Zhvleresimi (Renia ne vlere),

Shoqeria vlereson ne çdo date raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet. Ne rast se evidentohet mundesia per zhvleresim, atehere vleresohet vlere e rikuperueshme e aktivitetit. Per aktivet e patrupezuara qe nuk jane te gatshme per perdorim, vlere e rikuperueshme perlllogaritet ne çdo date te bilancit.

Nje zhvleresim njihet atehere kur vlere kontabel e nje aktiv apo vlere e flukseve qe do te gjenerojë, eshte me e madhe se vlere e rikuperueshme e aktivitetit. Vlere e flukseve qe gjenerohen eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse te parase qe jane kryesisht te pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvleresimet njihen ne pasqyren e fitimeve dhe humbjeve.

Provizionet

Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

Provizionet përcaktohen duke skontuar (nese eshte materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me gjasa per daljen e ndonje fluksi parashe per shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet perdoren vetem per qellimin qe jane njohur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtezuara nuk njihen por paraqiten ne shenime kur jane sinjifikative.

Konvertimi i monedhave te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni.

Aktivitet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore me 31/12/2017. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe te huaj në datën e hartimit të bilancit jane si me poshte (ne LEK):

Monedha	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.1	128.17

Të ardhurat - Njohja

Te ardhurat nga shërbimet regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me perfundimin e shërbimit ne daten e raportimit.

Te ardhurat nga shitja e produktit te vete dhe te ardhura te tjera, njihen ne momentin e dorezimit te mallrave kur e drejta e pronësisë dhe rreziku i humbjes i kalojne klientit

Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe tatim fitimi per shpenzimet e panjohura

AUDITUESE E PAVARUR

Shpresa BREÇANI

Tirane , me 27.03.2018 .



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)				
Nr	A K T I V E T		2,017	2,016
	Aktivët Afatshkurtra			
	▶ Aktivët monetare			
	1	Banka	3,693,824.98	41,702.72
	2	Arka	3,692,483.78	40,361.52
			1,341.20	1,341.20
	▶ Investime			
	1	Në tituj pronësie të njësisë ekonomike brenda grupit		
	2	Aksionet e veta		
	3	Te tjera Financiare		
	▶ Të drejta të arkëtueshme			
	1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	7,092,348.16	7,221,737.36
	2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit	3,985,752.16	4,115,141.36
	3	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	4	Të tjera		
	5	Kapital i nënshkruar i papaguar	3,106,596.00	3,106,596.00
	▶ Inventarët			
	1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		
	2	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte		
	3	Produkte të gatshme		
	4	Mallra		
	5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)		
	6	AAGJM të mbajtura për shitje		
	7	Parapagime për inventar		
	▶ Shpenzime të shtyra		29,084,212.00	24,118,967.33
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		39,870,385.14	31,382,407.41
	Aktivët Afatgjata			
	▶ Aktive financiare			
	1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		
	2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		
	3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		
	6	Tituj të tjerë të huadhënies		
	▶ Aktivët materiale			
	1	Toka dhe ndërtesa	594,715,808.58	626,023,950.58
	2	Impiante dhe makineri	594,689,766.25	625,989,227.25
	3	Të tjera Instalime dhe pajisje	26,042.33	34,723.33
	4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces		
	▶ Aktivët biologjike			
	▶ Aktive jo materiale:			
	1	Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		
	2	Emri i Mirë		
	3	Parapagime për AAJM		
	▶ Aktive tatimore të shtyra			
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar			
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		594,715,808.58	626,023,950.58
	AKTIVE TOTALE		634,586,193.72	657,406,357.99

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)			
Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	2017	2016
▶	Detyrime afatshkurtra:	481,844,757.64	453,626,333.64
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	144,953,949.60	144,315,349.60
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>	333,949,590.98	307,904,590.98
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	2,404,345.00	725,315.00
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	536,872.06	681,078.06
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		
▶	Të ardhura të shtyra		
▶	Provizione		
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera	481,844,757.64	453,626,333.64
▶	Detyrime afatgjata:	139,686,254.13	182,159,125.77
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	139,686,254.13	182,159,125.77
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
8	<i>Të tjera të pagueshme</i>		
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		
▶	Të ardhura të shtyra		
▶	Provizione:		
1	<i>Provizione për pensionet</i>		
2	<i>Provizione të tjera</i>		
▶	Detyrime tatimore të shtyra		
	Totali i Detyrimeve afatgjata	139,686,254.13	182,159,125.77
	DETYRIMET TOTALE	621,531,012	635,785,459.41
▶	Kapitali dhe Rezervat		
▶	Kapitali i Nënshkruar	1,000,000.00	1,000,000.00
▶	Primi i lidhur me kapitalin		
▶	Rezerva rivlerësimi		
▶	Rezerva të tjera	20,620,898.58	5,681,934.00
1	<i>Rezerva ligjore</i>	1,031,045.00	284,097.00
2	<i>Rezerva statutore</i>		
3	<i>Rezerva të tjera</i>	19,589,853.58	5,397,837.00
▶	Fitimi i pashpërndarë		
▶	Fitim / Humbja e Vitit	- 8,565,716.63	14,938,964.58
	Totali i Kapitalit	13,055,181.95	21,620,898.58
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	634,586,193.72	657,406,357.99



Pasqyra e Performancës			
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)			
<i>Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës</i>			
Nr	Pershkrimi i Elementeve	2017	2016
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	38,233,528	64,027,807
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-	- 10,640
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		- 10,640
	2 Të tjera shpenzime		
▶	Shpenzime të personelit	- 8,387,204	- 9,026,554
	1 Paga dhe shpërblime	- 7,262,464	- 7,923,636
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	- 1,124,740	- 1,102,918
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	- 31,308,142	- 32,958,376
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	- 2,615,673	- 3,504,808
▶	Të ardhura të tjera	-	559,708
	1 Të ardhura nga njësitet ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)		
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)		
	3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)		559,708
▶	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		
▶	Shpenzime financiare	- 4,488,226	- 1,511,884
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit)	- 4,488,215	- 1,511,843
	2 Shpenzime të tjera financiare	- 11	- 41
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
▶	Fitimi/Humbja para tatimit	- 8,565,717	17,575,253
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	- 2,636,288
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		- 2,636,288
	2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë		
	3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve		
▶	Fitimi/Humbja e vitit	- 8,565,717	14,938,965
▶	Fitimi/Humbja për:		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		
Pasovra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse			
Nr	Pershkrimi i Elementeve	2017	2016
▶	Fitimi/Humbja e vitit	- 8,565,717	14,938,965
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	38,233,528	64,027,807
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		
	Diferencat (+/-) nga riveerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Diferencat (+/-) nga riveerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	38,233,528	64,027,807
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	38,233,528	64,027,807
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare			
<i>(metoda direkte)</i>			
		2,017	2016
►	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	20,080,005.00	26,868,020
	<i>Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme</i>	45,069,602.00	87,754,408
	<i>Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve</i>	- 6,402,983.00	- 47,393,547
	<i>Pagesa të tjera</i>	- 605,449.00	
	Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit	- 17,981,165.00	- 13,492,841
	<i>Interes i paguar</i>	- 9,453,459.00	
	<i>Tatim fitimi i paguar</i>	- 8,527,706.00	- 13,492,841
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
►	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	26,045,000.00	22,530,000
	<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
	<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
	<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		
	<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		6,180,000
	<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
	<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
	<i>Dividentë të arkëtuar</i>	26,045,000.00	16,350,000
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
►	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	- 42,472,872.00	- 52,776,668
	<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
	<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
	<i>Hua të arkëtuara</i>		
	<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
	<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>		
	<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
	<i>Pagesa e huave</i>	- 42,472,872.00	- 42,472,872
	<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
	<i>Interes i paguar</i>		- 10,303,796
	<i>Dividendë të paguar</i>		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve mone	3,652,133.00	- 3,378,648
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	41,703.00	3,420,351
	<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	11.00	
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	3,693,825.00	41,703

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto											
	Kapitali nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivaluesimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	1,000,000	-	-	-	-	-	-9,021,433	14,703,367	6,681,934		6,681,934
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	1,000,000	-	-	-	-	-	-9,021,433	14,703,367	6,681,934		6,681,934
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit								14,938,965	14,938,965		14,938,965
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:				284,097		5,397,837	9,021,433	-14,703,367	-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	1,000,000	-	-	284,097	-	5,397,837	-	14,938,965	21,620,899		21,620,899
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	1,000,000	-	-	284,097	-	5,397,837	-	14,938,965	21,620,899		21,620,899
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit								- 8,565,717	- 8,565,717		- 8,565,717
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:				746,948		14,192,017		-14,938,965	-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	1,000,000	-	-	1,031,045	-	19,589,854	-	- 8,565,717	13,055,182		13,055,182